



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 132, datë 14.11.2022

PËR

MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË VENDIMIT TË KËSHILLIT BASHKIAK NR. 117, DATË 30.09.2021, PËRSA I PËRKET NDRYSHIMIT TË LISTAVE EMËRORE TË FAMILJEVE PËRFITUESE TË MASËS SË GRANTIT TË RINDËRTIMIT TË BANESAVE INDIVIDUALE SI PASOJË E DËMEVE TË SHKAKTUARA NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019, PËR SHKAK TË PAMUNDËSISË PËR TË RINDËRTUAR NË TË NJËJTIN TRUALL DHE KALIMIN E TYRE NË NJË PROGRAM TJETËR

Në zbatim të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Aktit Normativ nr.9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore” miratuar me Ligjin nr.97/2019, VKM nr. 5, datë 06.01.2020 “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model” i ndryshuar, VKM nr.904, datë 24.12.2019 “Për përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituese nga disa programe të procesit të rindërtimit” i ndryshuar, si dhe sipas relacionit të hartuar nga Komisioni i Posaçëm për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga programet e procesit të rindërtimit, në Bashkinë Durrës, me propozim të Kryetares së Bashkisë,

KËSHILLI BASHKIAK
V E N D O S I :

1. Miratimin e ndryshimit të Aneksit 1 bashkëlidhur Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 117, datë 30.09.2021 “Për miratimin e listës së gjashtë të 38 subjekteve përfituese, të cilët do të përfitojnë masën e grantit të rindërtimit të banesave individuale të dëmtuara nga tërmeti i datës

26 nëntor 2019, sipas projektit model”, duke hequr nga lista emërore e familjeve përfituese të grantit të rindërtimit të banesave individuale, për shkak të pamundësisë për të rindërtuar në të njëjtin truall të subjektit përfitues, znj. Edlira Huqi me numër rendor 23.

2. Miratimin e subjektit përfitues, i cili do të përfitojë nga programi i zhvillimit të zonave të reja, Manëz, sipas tabelës së mëposhtëme.



NR	NJËSIA ADM	EMRI	ATESIA	MBIEMRI	PËRBËRJA FAMILJARE	STRUKTURA E BANESES	ZONA E RE
1	MANËZ	EDLIRA	ZYBER	HUQI	3	2+1	MANËZ

3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimeve Publike, Komisioni i Posaçëm dhe Zyra e Posaçme e Rindërtimit, Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike pranë Drejtorisë së Shërbimeve Publike.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dyrmishi



U shpall sot me datë 15.11.2022






REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DURRËS

Nr. 864 / prot.
5

Durrës, më 16.11.2022

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

KËSHILLIT BASHKIAK
DURRËS



KRYETARIT TË BASHKISË
DURRËS

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.132 datë 14.11.2022 “Për miratimin e ndryshimit të Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 117, datë 30.09.2021, përsa i përket ndryshimit të listave emërore të familjeve përfituese të masës së grantit të rindërtimit të banesave individuale si pasojë e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 nëntor 2019, për shkak të pamundësisë për të rindërtuar në të njëjtin truall dhe kalimin e tyre në një program tjetër”

Ky vendim në bazë të Ligjit nr 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative” neni 3 pika 2 nuk është akt me karakter normativ. Vendimi është akt administrativ individual bazuar në nenin 3 pika 1/a të Ligjit nr 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, pasi i drejtohet subjekteve të përcaktuar individualisht duke krijuar një marrëdhënie juridike konkrete si dhe është i shteruar në zbatimin e tij.

Në bazë të Ligjit Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut” (neni 8/a) “Prefekti i qarkut verifikon ligjshmërinë e vendimeve, urdhrave dhe urdhërësive me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore”

Për sa më sipër verifikimi i këtij vendimi duke qenë një akt administrativ me karakter individual nuk është në kompetencën e Prefektit të Qarkut.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

EMILJAN JANI

